
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rehabilitim i Skemes vaditëse Llakatund VLU3”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

45210000-2

Fondi limit: 16 891 459(gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë lekë) pa TVSH.

Financimi per Vitin 2026: 3 416 666.67 leke pa tvsh

Financimi per Vitin 2027: 5 083 333.33 leke pa tvsh

Financimi per Vitin 2028: 5 224 792.50 leke pa tvsh

Financimi per Vitin 2029: 3 166 666.67 leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 e 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP-së “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 8 te DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim për deklarimin e xhiros vjetore, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (**2023, 2024, 2025**), në të cilat duhet të rezultojë se vlera e xhiros minimale vjetore të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet (vlera e kontratës që prokurohet).

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financioare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel minimal të kapacitetit ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, ajo mbështetet në Kreun V, Seksioni III, nenin 43, pikat 2 dhe 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, që përcakton mënyrën e verifikimit të kapaciteteve financiare përmes xhiros vjetore të operatorit ekonomik. Vlera e xhiros vjetore të kërkuar (jo më e vogël se fondi limit për të paktën një nga tre vitet e fundit) është vendosur në përpjesëtim të drejtë me natyrën e objektit të prokurimit. Ky objekt kërkon financime të qëndrueshme dhe aftësi të operatorit për të përballuar flukset monetare gjatë zbatimit të kontratës, përfshirë pagesat për furnizime, personel, pa penguar vijimësinë e punimeve. Kjo kërkesë është gjithashtu në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, konkretisht me nenin 64 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”, të ndryshuar, dhe Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Përmes këtyre dispozitave garantohet që të dhënat e xhiros të jenë të certifikuara nga autoritetet tatimore dhe të pasqyrojnë realisht qëndrueshmërinë financiare të operatorit.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009, neni 41, pika c”, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve, kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk*

ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”; Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar; kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar.

Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, siguron qëndrueshmëri financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Ky kriter është ligjërues i bazuar, proporcional dhe në raport të drejtë me natyrën e objektit të kontratës.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për të dëshmuar se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026 (këstet e maturuara), referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur. Në rast vetëdeklarimi të rremë do të vepohet në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin e fundit financiar, përfshirë këstet e maturuara, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 74 të tij. Shlyerja e detyrimeve vendore siguron që operatori ekonomik të jetë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të mos ketë detyrime të prapambetura ndaj administratës vendore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një procedure publike, ku përzgjedhja e operatorit duhet të garantojë integritet të plotë financiar dhe administrativ. Ky kriter është

ligjërisht i bazuar, i arsyeshëm dhe në përputhje me parimet e integritetit dhe kontrollit fiskal që kërkojnë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në kontrata publike, duke siguruar që subjektet pjesëmarrëse të jenë kontribuues aktivë dhe të ndershëm në sistemin tatimor e vendor të Republikës së Shqipërisë.

2.3 Kapaciteti teknik:

Për sa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/t Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in si dëshmi, vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 9, të DST,
 - Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - Situacionin përfundimtar të objektit shoqëruar me faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
 - Akt kolaudimi objekti;
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori/t Ekonomik duhet të të paraqes/in si dëshmi, vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore; dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes;
- Situacionin përfundimtar të objektit shoqëruar me faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
- Akt kolaudimi objekti;

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si vijon: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të vetëdeklarojë (sipas Shtojcës 8 të DST) se disponon fuqinë minimale punëtore jo më të vogël se **25 (njëzetë e pesë)** punonjës të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit për **1 muajin e fundit**.

Për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet që operatori ekonomik të paraqesë:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për **muajin e fundit**.

b) Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve prej 25 punonjës përfshin punëtorët të thjeshtë, stafin e kualifikuar të inxhinierëve, personel teknik, punonjës specializuar/të kualifikuar.

Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve si edhe kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë. Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në bazë të volumeve të punës dhe grafikut të punimeve.

2.3.4 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet.

2.3.4/1 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të paraqes me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 në DST:

Se disponon në stafin e tij si Drejtues Teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

1. Ing. Ndërtimi	1 (një)
2. Ing. Ndërtimi (Profil Gjeoteknik)	1 (një)
3. Ing. Hidroteknik	1 (një)
4. Ing. Gjeodet	1 (dy)
5. Ing. Mjedisi	1 (një)

Inxhinierët e sipërcituar, duhet të figurojnë si drejtues teknik në licensën e Operatorit Ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë minimumi për **muajin e fundit**.

Për inxhinierët, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

- Kontratat e punës materiale të vlefshme;
- Diplomat përkatëse;
- Cv

Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë minimumi për muajin e fundit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Operatori/ët ekonomik duhet të ketë një nga drejtuesit teknike **1(një) Menaxher Projektesh** si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit.

Operatori/ët ekonomik duhet të ketë një nga drejtuesit teknike 1 (një) punonjës me certifikatë "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për

miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit.

Operatori/ët ekonomik duhet të ketë një nga drejtuesit teknike 1 (një) punonjës me certifikatë "**Ekspert per Ndihmen I dhe nderhyrjen ndaj emergjencave**" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë., si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)	Nr Amzes
1					
2					
etj					

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore.
- **Të** figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit

Argumentimi: Kërkesa për personelin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "c".

Kriteri për personelin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët vjen nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafit pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mjedisi, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve. Duke pasur në vëmendje objektin e prokurimit gjykojme se është e domosdoshme që çdo Operator ekonomik ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si më sipër, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3.4/2 Operatori/et Ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) Drejtuesin/t Teknik të punimeve në kantier, për gjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të kontratës dhe të deklarojë se ai nuk është i dypunësuar apo i angazhuar në kontrata të tjera, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë punë e vlefshme;
- Diploma;
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë minimumi për **muajin e fundit**.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Drejtuesit Teknik nuk duhet të jenë të dypunësuar. Kjo në zbatim të V.K.M. Nr. 42, datë 16.01.2008, Kreu IV, pika 2. Si rrjedhojë O.E. duhet të deklarojë se Drejtuesit Teknik nuk janë të dypunësuar apo të angazhuar në ndonjë veprimtari tjetër jashtë O.E. pjesëmarrës. A.K. rezervon të drejtën e verifikimit të Deklaratës.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi:

Kërkesa që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të disponojnë një drejtues teknik, me kualifikimin dhe eksperiencën profesionale të përshtatshme për natyrën e punimeve objekt kontrate, është përcaktuar duke marrë në konsideratë kompleksitetin teknik dhe rëndësinë e punimeve që do të realizohen në kuadër të objektit të prokurimit.

Për shkak të natyrës së këtyre punimeve, është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë në dispozicion një personel teknik të kualifikuar, i cili të jetë përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin teknik të punimeve në kantier, interpretimin dhe zbatimin korrekt të projektit, specifikimeve teknike dhe preventivit, si dhe kontrollin e cilësisë së punimeve të realizuara.

Drejtuesi teknik do të ketë rol të rëndësishëm në organizimin dhe koordinimin e punimeve dhe të mjeteve/makinerive në kantier, ndjekjen e zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe preventivin, përcaktimin dhe koordinimin e mënyrës së realizimit të proceseve të punës;

kontrollin e kuotave, seksioneve dhe parametrave teknikë të kanalit, sipas kërkesave të projektit; mbikëqyrjen e punimeve të gërmimit, pastrimit, sistemimit dhe rehabilitimit, koordinimin e punës së operatorëve të makinerive dhe personelit të angazhuar në kantier, evidentimin dhe trajtimin në kohë të problematikave teknike që mund të lindin gjatë zbatimit, garantimin e respektimit të kërkesave teknike dhe të rregullave të sigurimit teknik në kantier, koordinimin e proceseve të ngarkimit, transportit dhe depozitimit të materialeve dhe mbetjeve të krijuara nga punimet.

Përcaktimi i drejtuesit teknik është gjithashtu i nevojshëm për të siguruar vazhdimësinë dhe kontrollin teknik të punimeve, duke shmangur realizimin e tyre në mënyrë të pakontrolluar dhe duke garantuar që çdo ndërhyrje në kanalin kullues të kryhet sipas parametrave të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe me natyrën e punimeve dhe nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin e kapacitetit teknik dhe profesional të operatorit ekonomik për realizimin me cilësi të kontratës.

Kërkesa konsiderohet e nevojshme, objektive dhe proporcionale me objektin e prokurimit, pasi përgjegjësia për drejtimin teknik nga një person kompetent ndikon drejtpërdrejt në cilësinë, sigurinë, korrektësinë teknike dhe përfundimin në kohë të punimeve.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor e konsideron të arsyeshme kërkesën që operatori ekonomik të disponojë një drejtues teknik të kualifikuar, i cili do të jetë përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin teknik të punimeve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

2.3.4/3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë (sipas shtojcës 8 të DST) se ka minimumin punonjës specialist për kryerjen e punimeve, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë :

- Teknik Ndërtimi	1 (një)
- Teknik Topograf/Gjeodet/Gjeometër	1 (një)
- Betonues	3 (tre)
- Hekurthyes	2 (dy)
- Karpentier	2 (dy)
- Saldator	1 (një)
- Automakinist	3 (tre)
- Buldozerist	1 (një)
- Eskavatorist	2 (dy)
- Shofere me CAP	4 (kater)

- Operatori ekonomik duhet që për Saldatorin e deklaruar, të jetë i pajisur dhe i certifikuar. Për permbushjen e këtij kriteri do të pranohen vetëm certifikatat e lëshuara nga institucione të akredituara përkatëse ose ekuivalentin e tyre dhe kontratat e punës.

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)	Nr Amzes
1					
2					
etj					

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore.
- Të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit

(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë)

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentet e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licencuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Percaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punes si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në këto elemente të strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është

përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

2.3.5 Operatorët Ekonomike, duhet të disponojnë liçensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë, duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Shqyrtimi i liçensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Liçensa profesionale e Operatorit Ekonomik, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës dhe duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

1. NP – 1 A Punime gjurmimi në tokë;
2. NP – 5 A Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti;
3. NP – 9 A Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

1. NS – 7 A Barriera dhe mbrojtje lumore;
2. NS – 18 A Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj, duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës), Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, date 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Kategoritë e liçensave janë vendosur në përputhje me zërat e preventivit. Llojet e liçensave dhe klasifikimi i tyre janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve dhe vlerën e përlogaritur të kontratës.*

2.3.5/a Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me liçensë lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim, ruajtje dhe transport të mbetjeve inerte), së bashku me aktin e

miratimit dhe kodet 17 05 04 , 17 09 04, 20 02 02, 20 03 04, 20 03 06, 01 04 10 , 17 08 02, , në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi; Kërkesa për disponimin e licencës III.2.B është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën dhe specifikat e objektit të kontratës, i cili përfshin punime për pastrimin, rehabilitimin dhe/ose sistemimin e kanalit vadites. Gjatë realizimit të këtyre punimeve, si rezultat i pastrimit të kanalit, largimit të materialeve të depozituara, gërmimeve, heqjes së materialeve inerte dhe materialeve të tjera të padëshiruara, krijohen mbetje të cilat duhet të grumbullohen, ngarkohen, transportohen dhe të dërgohen në destinacionin përkatës, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve.

Për këtë arsye, realizimi i plotë dhe i rregullt i kontratës nuk kufizohet vetëm në kryerjen e punimeve fizike në trupin e kanalit, por përfshin edhe menaxhimin e materialeve dhe mbetjeve që rezultojnë gjatë zbatimit të tyre. Mosmenaxhimi i tyre mund të sjellë depozitim të pakontrolluar të materialeve në zona të papërshtatshme, ndotje të tokës dhe ujërave, si dhe pasoja administrative dhe mjedisore për autoritetin kontraktor dhe operatorin ekonomik.

Kërkesa për licencën synon, në këtë mënyrë, të garantojë që operatori ekonomik që do të realizojë këtë pjesë të kontratës duke siguruar që ato të menaxhohen dhe të transportohen drejt destinacionit të përcaktuar nga legjislacioni dhe dokumentet e kontratës.

Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin dhe zërat e preventivit, pasi menaxhimi i materialeve të dala nga kanali është pjesë e domosdoshme e procesit të zbatimit të punimeve dhe përfundimit të tyre në kushtet e kërkuara teknike dhe mjedisore.

Gjithashtu, kërkesa është përcaktuar në respektim të parimit të proporcionalitetit, pasi nuk synon të kufizojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, por të sigurojë që operatori që merr përsipër menaxhimin dhe transportin e mbetjeve të disponojë licencën e nevojshme për këtë veprimtari.

2.4 Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qera; Dëshim për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Operatori/ët ekonomik, të vetëdeklarojnë sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), për mjetet dhe paisjet si më poshtë:

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Eskavator me goma (mjet teknologjik)	2 copë	Në pronësi ose me qera

2	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
3	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 3.5-5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 1-1.5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
5	Autovinc deri 5-6 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Fadrome me goma (mjet teknologjik)	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Minifadrome (mjet teknologjik)	2 copë	Në pronësi ose me qera
8	Minidumper (mjet teknologjik)	1 copë	Në pronësi ose me qera
9	Autobetoniere kantieri deri ne 3.5 m3 (mjet teknologjik)	2 copë	Në pronësi ose me qera
10	Autobot uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
11	Vibratorë betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
12	Motogjeneratorë	1 copë	Në pronësi ose me qera
13	Tabela sigurimi në punë	20 copë	Në pronësi ose me qera
14	Kontenierë për puntorë	1 copë	Në pronësi ose me qera
15	Jelekë, kokore	25 copë	Në pronësi ose me qera
16	Prozhektor ndriçimi	5 copë	Në pronësi ose me qera
17	Fikse zjarri	5 copë	Në pronësi ose me qera
18	Kuti ndihme e shpejtë	5 copë	Në pronësi ose me qera
19	Karro Dore	10 copë	Në pronësi ose me qera
20	Depozitë materialesh	2 copë	Në pronësi ose me qera
21	Paisje saldimi me elektrofuzion	1 copë	Në pronësi ose me qera
22	GPS	1 copë	Në pronësi ose me qera
28	Eskavator me zinxhir mbi 20 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
29	Eskavator me krahë të gjatë mbi 18 m	1 copë	Në pronësi ose me qera

Ky dokumentacion, përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST-së.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:

A. Për mjetet në Pronësi që shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Çertifikatë mbi Pronësinë e mjetit rrugor, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
2. Leje qarkullimi, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
3. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
4. Police për sigurimin e detyrueshem ndaj palëve të treta (T.P.L.), të vlefshme, lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar.
5. Çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit në pronësi ose për të tretë (e vlefshme).

B. Për mjetet me Qera që shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Çertifikatë mbi Pronësinë e mjetit rrugor, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
2. Leje qarkullimi, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
3. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
4. Police për sigurimin e detyrueshem ndaj palëve të treta (T.P.L.), të vlefshme, lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar.
5. Kontrata përkatëse e qerasë, e vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës.
6. Çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit në pronësi ose për të tretë (e vlefshme).

C. Për mjetet në Pronësi që nuk shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Fatura tatimore e blerjes, akt çdoganimi për mjetet e importuara.

D. Për mjetet me qera që nuk shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Fatura tatimore të blerjes, akt çdoganimi për mjetet e importuara;
2. Kontrata përkatëse e qerasë, e vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës.

E. Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i ndryshuar, si më poshtë vijon duhet të disponojë :

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Autoriteti Kontraktor, rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të vetëdeklaruar (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese) sipas Shtocës Nr. 8 të DST-së. Në rast deklarimi të rremë, do të vepohet në përputhje të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.5 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë certifikatat të vlefshme si më poshtë:

- **Çertifikatë SSH EN-ISO 9001-2015** ose ekuivalenti i tij (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë, e vlefshme*). Në rastë bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).
- **Çertifikatë SSH EN-ISO 14001-2015** ose ekuivalenti i tij (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit, e vlefshme*). Në rastë bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).
- **Çertifikatë SSH ISO 45001:2018** ose ekuivalenti i tij (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e vlefshme*). Në rastë bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).

Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, çdo anëtar i grupit, duhet të paraqesë përkatësisht Çertifikatën ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Akt – Marrëveshjes).

Nëse ofertuesi do të paraqitet si Bashkim Operatorësh, certifikatat duhet të jenë në përputhje me punimet e marra sa më sipër.

Argumentim: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.4.1 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 *Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarde të cilësisë, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve,*

përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë.

ISO 45001-2018 Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

ISO 14001:2015 është një standard ndërkombëtar që ka të bëjë me menaxhimin e mjedisit dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullatorë për mbrojtjen e mjedisit. Kjo certifikatë siguron që kompania ndërtuese ka implementuar praktika dhe sisteme për të menaxhuar ndikimet mjedisore të punimeve, si ndotja e ajrit, ujërave dhe menaxhimi i mbetjeve.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Certifikatat e kërkuara brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik.

Certifikatat e kërkuara janë në përpjesëtim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.7 Operatorët Ekonomik ofertues duhet të paraqesin grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST-së), të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: “a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”

Grupi i hartimit të specifikimeve referuar të dhënave teknike në projektin e hartuar nga projektuesi ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej 90 (nëntëdhjetë) ditë, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

Këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Në mbështetje të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me natyrën dhe kërkesat funksionale të objektit **“Rehabilitim i Skemes vaditëse Llakatund VLU3”**, duke garantuar konkurrencë të barabartë, trajtim të paanshëm dhe përdorim eficient të fondeve publike. Specifikimet teknike janë pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit dhe përcaktojnë standardet minimale të cilësisë, makineritë dhe kontrollin teknik të punimeve.

Nga ana teknike, specifikimet teknike sigurojnë përshkrim të qartë të volumeve të punës, metodave të zbatimit dhe kriterëve të matjes.

Dokumentacioni teknik përfshin gërmime dheu, prerje bimesie, transport dheu, mbushje, rrafshim, ngjeshje, strukture monolite betoni, ure kalimi, f.v konstruksione metalike, të cilat janë parashikuar të realizohen sipas kushteve teknike të zbatimit dhe standardeve përkatëse.

Gjithashtu, specifikimet teknike parashikojnë detyrimin e kontraktorit për të garantuar cilësinë e e punimeve.

Këto kërkesa synojnë garantimin e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe funksionalitetit afatgjatë të investimit publik.

Specifikimet teknike, preventivi i punimeve, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

NJËSIA E PROKURIMIT